



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality of Rahovec

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Odeljenje za Kulturę, Omladinu i Sport



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

13 Nr. Zyrtar – 2020

Dt.: 14.08.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-48, për Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L -222 dhe Ligjit Nr.04/L -116 nenit 58, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Nr.03/L-040,(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës,28/2008), nenit 5,7 dhe 8 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve Nr.1427 e datës 28.04.2017, dispozitat e nenit 8, 10, 12 dhe 16 të Rregullores MF-Nr 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 74, dhe nenit 92, paragrafi 4, të statutit të Komunës Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe Thirrjes Publike të datës 05.06.2020, bazuar në Vendimin Nr.929 të datës 30.06.2020, për formimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlersimin e Aplikacioneve për ndarjen e Subvencioneve nga DKRS-ja për vitin 2020, Komisioni Vlersues nxjerr këtë:

VENDIM

1. Në përputhje me afatet, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit vlerësues të përcaktuara me rregulloret e lartëcekura dhe vendim të Kryetarit të Komunës dhe mbi bazën e thirrjes publike të datës 05.06.2020, Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjitha aplikacionet dhe dokumentacionin përkatës të dërguar nga OJQ – të, ku sipas kriterëve, Komisioni Vlerësues ka shpallur fitues për Subvencionim këto OJQ dhe Individ:

Nr	TITULLI I PROJEKTIT	PERFITUESI	BARTESI I PROJEKTIT	KLASIFIKIMI
1	ORGANIZIMI I MANIFESTIMEVE PËR DËSHMORËT E KOMBIT	OVL- UÇK -së	VAJDIN BERISHA	1872
2	ZHVILLIMI I ARTIZANATEVE 2020	“TRADITA SHQIPTARE ANADRINI”	SERVETE KASTRATI	1932
3	KOLONIA E ARTISTAVE ME KARAKTER NDËRKOMBËTAR	OJQ “ART STUDIO”	SELAMI HAXHIJAH	1984
4	BOTIMI I KUMTESAVE KUSHTUAR VEPRIMTARIT “UKSHIN HOTI”	OJQ “SHOQATA ARBËRIA”	DERVISH ÇADRAKU	2050
5	KULTURA DHE PROGRAMET KULTURORE NË RAHOVEC	SH.K.A “RAHOVECI”	FATOS HASKU	2021
6	FESTIVALI I KËNGËS POPULLORE “N’ KONAK TË RAHOVECIT”	OJQ “INK-RINORE”	NASER DULA	2037
7	PËRGATITJA DHE PROMOVIMI KULTUROR 2020	SH.K.A “ANADRINI”	XHAHER BYTYQI	2115
8	FESTIVALI FOLKORIK “ANADRINIA JEHON 2020”	OJQ- “JEHONA E ANADRINIT “	SALIH BYTYQI	2008
9	FESTIVALI NËRKOMBËTAR I POEZISË	OJQ-FEKT	FAHREDIN SHEHU	1976
10	TRAJNIME PËR RADIO-GAZETARI	QENDRA RINORE “SHL KOSOVA”	ENIS DURGUTI	2010

11	GRAPELANDERS WALLART	OJQ – GRAPELNADS KOSOVA	QENDRIM GASHI	2041
12	SENSIBILIZIMI KULTUROR I TË RINJËVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT	KUVENDI I TË RINJËVE	ARDIT HALILAJ	2009
13	PËRGATITJA E KOREOGRAFISË PËR SHOQERINË KULTURORE-ARTISTIKE	SH.K.A "GANIMETE TËRBESHI"	MURAT KRYEZIU	2000
14	MONOGRAFI PËR DËSHMORIN SKENDER GASHI	"ART MUZA " RAHOVEC	SHTËPIA BOTUESE	1191
15	TRAJNIME PSIKO-SOCIALE PËR TË RINJTË E KOMUNËS SË RAHOVECIT	OJQ-KËSHILLI RINOR I RAHOVECIT	ENIS BERISHA	2035
16	TA NJOHIM TRASHËGIMINË PËR MES FOTOGRAFISË	SHQIPRON BERISHA	SHQIPRON BERISHA	2042
17	PROMOVIMI DHE RUAJTJA E VLERAVE TË TRASHËGIMISË	FLORENT KRASNIQI	FLORENT KRANSIQI	2025
18	VIDEO REPORTAZH TË MONUMENTEVE HISTORIKE	ARBËR MORINA	ARBËR MORINA	2105
19	BOTIMI I LIBRIT	SHEQAJDIN DURGUTI	SHEQAJDIN DURGUTI	1905
20	REALIZIMI I AUDIO INÇIZIMIT TË KËNGËS	SABRIJE HOTI	SABRIJE HOTI	1891
21	MONOGRAFI PËR DËSHMORIN " MILAIM KRASNIQI "	PAJAZIT KRASNIQI	PAJAZIT KRANIQI	1990

Pas kalimit të afatit të ankesave dhe të procedurave të tjera të parapara në rregulloret e lartëcekura, Kryetari i Komunës do të nënshkruajë kontratat me përfituesit e mjeteve financiare me të gjitha OJQ-të dhe individë përfitues.

ARSYETIM

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ – të, brenda afatit të përcaktuar ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni, dhe në përputhje me rregulloret e lartëcekura, ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni dhe mbi bazën e thirrjes publike nga 52 aplikacione, kriteret i kanë plotësuar 42 dhe janë refuzuar 10 aplikacione për shkak të dokumentacionit jo të kompletuar dhe mos përmbajtjes të kriterëve në Thirrjen Publike për OJQ-të dhe Individ.

Të gjitha palët e pakënaqura me punën e Komisionit për listën finale të lartcekur nga Kultura dhe Rinia, mund të ushtrojnë ankesë te komisioni për shqyrtimin e ankesave për subvencione, në Drejtorinë e Kulturës, në afat prej 5 (pesë) ditë pune, nga data e publikimit të kësaj liste finale në tabelën e shpalljeve dhe Web-faqe të Komunës.

Udhëzim Juridik: Kundër këtij vendimi lejohet ankesë në afat prej 5 ditësh, pranë Komisionit për Shqyrtim dhe Vlerësimin e Ankesave të OJQ –ve në Komunën e Rahovecit.

- Ankesat dorëzohen me shkrim ne sportelin nr.7 në katin e parë në objektin e Komunës.

Anëtarët e komisionit :

1. Shedat Ukaj –Kryesues

2. Muharem Morina –Anëtar

3. Feriz Thaqi –Anëtar

4. Saranda Rama –Anëtare

5. Duran Bytyqi-Anëtar

